REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 506/19
Datë/Datum. 09.09.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWEË BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **AK-Ministria e Shëndetësisë** OEankues **"Pharma Leader"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Ilir Haliti – Ekspert profesional shqyrtues i prokurimit Jeton Prenaj – Ekspert teknik		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.**506/19** të parashtruar nga OE : **"Farma Leader"** Prishtinë		
Datë	09.09.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:**13.08.2019** me nr. **506/19** të parashtruar nga OE **"Pharma Leader"**lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me barna nga Lista Esenciale për FSSH dhe DF ne MSH-Lot.10"**me nr. të prokurimit: **206-18-1227-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë**
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Shëndetësisë**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues-"Pharma Leader"

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT TEKNIK*

		28.08.2019	**09.09.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **13.08.2019** OE **"Pharma Leader"**ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me barna nga Lista Esenciale për FSSH dhe DF ne MSH-Lot.10"**me nr. të prokurimit: **206-18-1227-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

Konform nenit113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues dhe teknik i kane shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

1. **Operatori Ekonomik Ankues"Pharma Leader"**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues**"Pharma Leader"**, janë:

1. Neni 1 i LPP-së
2. Neni 6 i LPP-së
3. Neni 7 i LPP-së
4. Neni 59 i LPP-së
5. Neni 60 i LPP-së
6. Neni 64 i LPP-së
7. Neni 72 i LPP-së

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Ju sqarojmë se fillimisht, ne jemi rekomanduar për kontratë me dt:16.07.2019, ashtu siç ishim rekomanduar edhe një herë më herët, mirëpo pas kërkesës për rishqyrtim nga OE Lirimed, është aprovuar kerkesa për rishqyrtim është anuluar vendimi nga AK-ja dhe me pastaj është rekomanduar për kontratë këtë OE Lirimed, kurse neve na kane shpallur si tenderues te pasuksesshem.

Ju sqarojme se me dt:03.05.2019 (z.Ismed Hyseni) ka kerkuar sqarime nga Kabineti i Drejtorit te Pergjithshem te

Doganes se produkti "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC Code B03AC02 a lirohet nga detyrimi tatimor. Ndersa me dt:08.05.2019 Kabineti i Drejtorit te Pergjithshem te Doganes ka derguar sqarime duke sqaruar si ne vijim: "Sipas Ligjit nr.04/L-163 për Mallrat e liruara nga tatami doganor dhe mallrat me tarife zero te tatimit dganor pjesa D, Produkti medicinal "Ferric Hydroxide Sucrose complec" me ATC B03AC02", nuk lirohet nga detyrimi tatimor dhe se i njejti i nenshtrohet takses prej 8%.

Ne lidhje me këtë ceshtje, edhe ne si operator ekonomik me dt:18.01.2019 iu kemi drejtuar sektorit te tarifave, konkretisht z. Ekrem Grabanica për sqarime ne lidhje me këtë product, ndersa me te njejten date kemi marr pergjigje ku shkruan se **produkti ATC Code B03AC02 nuk lirohet nga detyrimi tatimor dhe i nenshtrohet detyrimit tatimor prej 8%,** ndersa ne vazhdim te sqarimit shkruan: Besoj se ketu kemi nje keqkuptim me ferric Hydroxide me ATC Code B03AC02, i cili lirohet nga detyrimet doganore dhe tatimore.

Ne lidhje me ceshtjen e TVSH, ekziston edhe interpretimi i KRPP-se tek pyetja nr.46, e po ashtu edhe interpretimin e KRPP-se te dt:22.01.2019 ku shkruan se *"Ne rast se nje operator ekonomik ofron nje cmim ku % (perqindja) e TVSH-se është gabuar (me e larte apo me e ulet se norma e aplikueshme e TVSH-se) ose nuk vendos, autoriteti kontraktues do te korrigjoje % (perqindjen) e atij apo atyre artikujve ne baze te norms se aplikueshme te TVSH-se pa pasur nevoje te kerkoje sqarime shtese nga operatori ekonomik ne fjale".*

Interpretimin e KRPP-se, po ua rikujtojme me arsyen se edhe nese eventualisht produkti ATC Code B03AC02 lirohet nga detyrimi tatimor, ateherë autoriteti kontratktues është dashur te korrigjoje TVSH tek oferta jone, dhe me pastaj, ne perseri do te jemi fitues i ketij tenderi, sepse nese na zbritet TVSH-ja, perseri jemi me cmim me te ulet se OE i rekomanduar për kontratë.
Nuk është ceshtje e AK-se, si autoritet kontraktues se a kemi paguar ne TVSH apo nuk ka paguar TVSH OE i rekomanduar për kontratë, por ne këtë rast është e rendesishme se **produkti ATC Code B03AC02 a lirohet nga detyrimi doganor tatimor apo jo?.**

Pastaj nese nuk lirohet atëherë duhet ti shtohet TVSH OE te rekomanduar për kontratë, nese lirohet ateherë duhet ta na zbritet TVSH e cmimit te ofertes tonë. Pra thjesht ketu duhet ndjekur edhe zbatuar nje procedure uniforme, sepse produkti është i njejte. Cili do prej varianteve te jetë ligjor dhe i sakt (edhe pse ky product ka TVSH) ne jemi fitues te kesaj kontratë.

Autoriteti kontraktues ne raportin e vleresimit e ka ceur se ne pamundesi ligjore qe ta obligoj OE Lirimed qe ta shtoj normen e TVSH-se nga 0% ne 8% për arsye se Dogana e Kosoves me vendimin nr.protokoli 1165 te dt:30.10.2018 e ka liru nga TVSH-ja, e kemi rekomanduar për kontratë me cmim me te ulet.
Ky arsyetim i AK-se është shume i njeanshem, tendencioz dhe aspak professional, sepse nuk është obligim i AK-se me obligu OE Lirimed me shut normen e TVSH-se, por obligim i AK-se është qe gjate vleresimit te ofertave me shut normen e TVSH-se, aq sa është me Ligj dhe sipas pyetjes dhe pergjigjes me Nr.46 te KRPP-se dhe sipas interpretimit te dt:22.01.2019 te KRPP-se, ose nese nuk ka TVSH ky product sipas legjislacionit ne fuqi ateherë është obligim i AK-se me na zbrite TVSH neve nga cmimi i ofruar.
Ne thjesh po kerkojme vetem trajtim te barabarte sipas ligjeve ne fuqi dhe asgje tejter.
Autoriteti kontraktues i ka verejtur shume mire se autorizim marketinget e OE LIRIMED dhe i joni, jane për te njejtn product dhe me ATC Code B03AC02 te njejte, prandaj është dashur njehere e mire te vendosin sipas legjislacionit ne fuqi, e qe realisht është dashur ti shtohet TVSH-ja, ofertes se OE LIRIMED DHE natyrisht te shpalleshim ne fitues te kesaj kontratë, ashtu siç na kane shpallur edhe dy here tjera.

Sa i perket sqarimit te z. Besnik Paqarada – Udheheqes i ZBD Aeroport-Departamenti Rajonal Prishtine-Dogana e Kosoves te dt:14.04.2019 drejtuar OSHP-se, edhe ne këtë sqarim ne fund shkruan se për sqarime tjera shtese ne nivel te ekspertizes, duhet te referoheni prane sektoreve profesional te Doganes se Kosoves, siç jane **sektori i tarifes, sektori i procedurace, zyra ligjore.**
Pra edhe ne këtë email kuptohet qe zyra për tarifa apo zyra ligjore është kompetente për te percaktuar sakte se a jane te liruar nga tatami doganor produktet perkatese.

Ne vendimin e AK-se te dt:06.08.2019, ne lidhje me kerkesen tonë për rishqyrtim AK-ja i referohet faktit se OE Lirimed e ka deshmuar se e ka importuar produktin ne fjale me norme 0% TVSH. Perseri AK-ja bene shmangie nga ceshtja kryesore se produkti ne fjale a ka TVSH me Ligj apo jo. Ne momentin qe OE Lirimed e ka deshmuar se e ka importuar produktin pa TVSH, ndersa ne e kemi importuar me TVSH ateherë autoriteti kontraktues është dashur te kerkoj sqarime nga institucioni kompetent, sektori apo zyra e cila është kompetente për te sqaruar këtë Ceshtje, e jot e vendos njeanshem ne favor te OE te rekomanduar për kontratë. Produkti është i njejtë me ATC kod te njejt dhe dispozitat e ligjeve ne fuqi duhet te vlejne njejte. Ndersa ceshtja e imortimit mund te jetë shume e diskutueshme dhe mund te jetë me leshime procedurale apo leshime te qellimta për te favorizuar kompanine fituese, por po kerkojme edhe njehere qe kjo ceshtje duhet te sqarohet nga organet dhe personat kompetent.
Perfundimisht autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit nuk e ka bere ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, njekohesisht e ka favorizuar operatorin ekonomik te rekomanduar për kontratë ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se, duke e shperblyer me kontratë edhe pse nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë, kurse paragrafi 4 i nenit 59 te LPP-se e parasheh qarte *"Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender sit e pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale është ne perpushmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit"*.
Ndersa oferta e ketij operatori ekonomik nuk është ne harmoni dhe perputhshmeri me te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.
Njekohesishte nuk është shfrytezuar ne menyre te drejte neni 72 i LPP-se.

Gjishashtu autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh edhe kriterin kryesor për dhenie te kontratës, e q aka qene tenderi i **pergjegjshem** me cmim me te ulet, ashtu siç e parasheh edhe neni 60.1.1 i LPP-se, sepse ne jemi operatori i pergjegjshem dhe me cmim me te ulet.

Ju rikujtojme se autoriteti kontraktues jane te obliguar qe te sigurojne qe fondet publike edhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonokike, njekohesisht duke marr ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit ashtu siq parashihet ne nenin 6 te LPP-se.

Gjithashtu duhet ti kene ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qellimi i ketije ligji është te siguroje menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.
Bashkengjitur i keni MAF te OE Lirimed dhe te kompanise tonë, ku mund te vertetoni se jane te njejtë dhe me ATC kon te njejte, e qe normalisht edhe rregullat për importim duhet te jene te njejta.

Demet Material:

Dëmet janë të konsiderueshme , pasi që vetëm përgaditja e dokumentacionit, kërkesës për rishqyrtim, ankesës

etj...arrin vlerën prej 5,000.00€

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 05.03.2018.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedure e Hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Furnizim/vlerë e madhe

Vlera e parashikuar e kontratës:.....Lot.10 - **99,960.00 €**

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... Çmimi më i ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....30.03.2018

Data e kërkesës për rishqyrtim.....05.08.2019

Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....06.08.2019

Kriteret për vlerësim:

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante te Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: **Emri i AK: MINISTRIA E SHËNDETËSISË** **Adresa e AK: ZAGREBIT , P.N.** **Qyteti: PRISHTINË** **Kodi Postar: -** **Adresa Elektronike:** *(ako se primenjuje)*: **http://msh-ks.org/** **Personi Kontaktues: Berat Marmullaku** **E-mail: berat.marmullaku@rks-gov.net** **Telefoni: 038 200 24 136** **Faks:**
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: **"Furnizim me barna nga Lista Esenciale për FSSH dhe DF ne MSH"** **206-18-1227-1-1-1**
	1.3	Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese Po ☐ Jo ☒ *[Nëse Autoriteti Kontraktues është duke prokuruar në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese sheno]* Autoriteti Kontraktues është duke prokuruar në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese Referojuni Aneksit 7 për Listen e Autoriteteve Kontraktuese me të drejtë të vendosjes se *[urdhër blerjeve] [ri-hapjes se konkurences]* nën kushtet e kësaj

		kontrate publike kornizë.
	1.4	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: **05.03.2018** Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e KRPP-së **ëëë.krpp.rks-gov.net.**
	1.5	Tenderi duhet të dorëzohet në adresen e përmendur në 24.1 përveç nëse nuk është e përmedur në 24.1 në adresen e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Qëllimi i kontratës është qe te përcaktohen kushtet qe rregullojne dërgesat e mallrave te shënuara me poshtë: *[shëno përshkrimin e përgjithshëm të furnizimeve dhe sasitë e vlerësuara të cilat MUND të blehen gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë]* **"Furnizim me barna nga Lista Esenciale për FSSH dhe DF ne MSH" 54 lote.**
	2.2	Qëllimi i Autoritetit Kontraktues është të lidhë një kontratë publike kornizë **me një operator ekonomik**. Prandaj urdhërat do të vendoset sa herë që të shfaqet nevoja
	2.3	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): **33000000-0**
Ndarja ne Lote	2.5	Ndarja ne Lote: Po ☒ Jo ☐ *Nëse objekti i tenderit është i ndarë në pjesë (lote) shëno:* *Objekti i kontratës është i ndare në* **54** *pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për:* ☐ vetëm një pjesë ☒ Të gjitha pjesët *Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1.* *Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është:* *[Sheno kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kritereve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal]*
Vlera e parashikuar	2.6	**Lot 10** — **€ 99,960.00**
Afati Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
Varijante	4.1	*Variante* autorizohen: Po ☐ Jo ☒ *[Nëse variantet janë të autorizuara, shëno:]* Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar. Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.2	Vendi i dërgesës është: **- Depoja Qendrore e barnave për Kujdesin Primar për DF.** **- Depot e Institucioneve Shëndetësore te kujdesit dytësor dhe tretësor për FSSH.**
	5.3	Kushtet e dërgesës: DDP (detyrat e dërguara të paguara)

	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej **12** muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.	
Kërkesat e përshtatshmërisë	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon: a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]* Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklarata nën Betim.**
		2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të Njoftimit per dhenje të Kontratës]	**2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës, kopje.**
		3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të	**3. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës (origjinal ose kopje e noterizuar).**

		tenderuesit.	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje.**
		2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.	**2. Certifikata e Numrit Fiskal – kopje.**
		3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove.	**3. Certifikata e TVSH-se – kopje.**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1. Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar direkt nga prodhuesi.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Autorizimi Origjinal me validitet, vetëm nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin: adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, për mundësi te verifikimit).**
		2. Te dëshmohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPM, me dozën e produktit te kërkuar.	**2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve te kërkuar.**
		3. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike.	**3. Licenca nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike, me validitet (me ripërtrirjen e fundit).**
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Nënkontraktimet	12.1	a) **një deklaratë** ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe b) Të gjithë nenkontraktorët do të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.	
Siguria e tenderit	13.1	*Shëno një nga opsionet:* Po ☒ Jo ☐ *Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:*	

		Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.
	13.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit është: **Lot 10 € 2,500.00** për periudhë valide prej **120** ditë
Siguria e ekzekutimit	14.1	*Shëno një nga opsionet vijuese:* Po ☒ Jo ☐ *[Nëse kërkohet siguria e ekzekutimit]* Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: **10% e vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj**
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	**15.03.2018**
Dokumentet qe përbejnë Tenderin	19.1 (h)	- Nëse ofertohet ne kopje te forte kërkohet Origjinal + 2 koje. - Nëse ofertohet si grup i operatoreve ekonomik – konsorcium, kërkohet qe secili anëtar i grupit te regjistrohet ne platformën e e-prokurimit. - Lejohet qe ofertimi me max. (3) numra pas pikës dhjetore (jo me shumë se 3 decimale).
Valuta dhe Përshkrimi i Çmimit	20.2	Çmimi i ofruar nga Tenderuesi nuk do të jetë i ndryshueshëm.
Krijimi i dokumenteve të përshtatshme të mallrave dhe shërbime të ngjashme	21.3	Nuk kërkohet nga tenderuesi të dorëzoj me tender listën e pjesëve rezervë
Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: **90** ditë, .
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	24.1	Afati i fundit për dorëzim është **30.03.2018**, në **14:00:00** orë Vendi: **MSH, zyra 007**
Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar		Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: **Po** ☒ **Jo** ☐ *Nëse po,* jep arsyetim: **Ky tender mundëson Furnizim me barna nga Lista esenciale e MSH sipas kërkesave te FSSH dhe Div. te Farmacisë, për nivelin parësor, dytësor dhe tretësor te kujdesit shëndetësor. Duke pasur parasysh faktin se pjesa me e madhe e këtyre artikujve janë ne ri-tenderim, kontratat paraprake kane skaduar, stoqet për këta artikuj janë shpenzuar dhe sipas Njësisë se Kërkesës nevojat janë shumë te mëdha për këta artikuj, andaj është shumë e nevojshme qe te procedohet me afatin e përshpejtuar ne 20 dite.** **Duke pas parasysh faktin se për pjesën me te madhe te këtyre artikujve nuk kemi kontrata valide për te bere furnizime shkurtimi i afatit ne 20 dite është mjaft i arsyeshëm.**
Hapja e Tenderit	27.1	Hapja e tenderit do te bëhet me: **30.03.2018** në **14:00:00** orë Vendi: **MSH, zyra 007**
Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** ☒
Ankesat	32.3	Shëno adresën e AK-së.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike për LOT 3:

Nr	Operatorët Ekonomik	Çmimi €	Çmimi me TVSH	Vërejtje
1.	LIRI MED SHPK		**78,540.00€**	**JO**
2.	Pharma Leader		**79,254.00€**	**JO**

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Agon Shala– Kryetar i komisionit
- Alban Thaqi– Anëtar i komisionit
- Egzon Ukshini - Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit në bazë të kriterit çmimi më i ulët rekomandon:

Për dhënie të kontratë rekomandojmë ofertën "Liri Med" SH.P.K në vlerë 78,540.00€
Të pasuksesshme rekomandojmë ofertën "Pharma Leader" për shkak të çmimit më të lartë.

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "Pharma Leader"

Përgjigje ne pretendimin nr.1

Pretendimi kryesor dhe i vetëm ankimorë nga OE ankues Pharma Leader, është se për Lot.10 OE i rekomanduar për kontratë ka aplikuar normën e gabuar të TVSH-së prej 0%.

Lidhur me këtë pretendim OE ankues ka ofruar si dëshmi përgjigjen e marrë nga Doganat e Kosovës, në të cilën sipas OE ankues konfirmohet se produkti në fjalë ka normën e TVSH prej 8%.

Në të njëjtën kohë OE i rekomanduar për kontratë i pretendon se produktin e kërkuar në lot.10 e ka importuar me 0% TVSH sipas vendimit ë Doganave të Kosovës.

Nga shklresat e lëndës në dsipozcionit , eksperti teknik dhe eksperti shqyrtues nuk mund të konstatojnë se produkti **"FERRIC HYDROXIDE sol per inj 20 mg / ml"** se a ka normë të TVSH-së 0% apo 8%, pasi që janë dy dëshmi kundërthënëse nga Dogana e Kosovës.

Me gjithë atë ekspertët shqyrtues konsatojnë se është nevojshme që përfundimisht të konstatohet-vërettohet nga AK dhe Doganat e Kosovës se sa është norma e sakt e TVSH-së për produktin **"FERRIC HYDROXIDE sol per inj 20 mg / ml'**, dhe pasi të konfirmohet norma e TVSH-së për këtë produkt , kjo normë të korrigjohet nga AK sipas dispozitave ligjore.

Mendimi i ekspertitShqyrtues/Teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, për arsyet te cilat u ceken ne Raport te Ekspertizës dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim.